



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1208 prot.

Fushë-Arrëz, më 28. 04. 2025



PROCESVERBAL

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 28. 04. 2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët:
Afrim Ndoj; Besjana Marku; Bardhok Qafa; Franc Doda; Lezina Ceca; Pavlin Qafa; Tereze Dema; Valentina Lleshaj; Valentin Doçi; Vjollca Tabakaj; Zef Cara.

(12 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje merr pjesë:

Hil Curri Kryetari i bashkisë

Mikel Qafa Zëvendëskryetar i bashkisë.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

Këshilltari **Lin Prendi** largohet nga mbledhja mbasi shënon prezencën për arsye familjare.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Prill 2025! Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen (12 këshilltarë) e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Para fillimit të mbledhjes si Doktor por edhe si Kryetar Këshilli ju bëj thirrje të gjitha grave dhe vajzave në territorin e bashkisë tonë të bëjnë ekzaminimin e "Mamografisë" sepse e kemi te planifikuar këtë javë por në varësi të kërkesave mund të shtyhet edhe për javën tjetër. Kjo është tejet e rëndësishme për shëndetin sepse një ekzaminim i thjeshtë në kohën e duhur mund të bëjë parandalimin e kancerit të gjirit që është një patologji e përhapur te gratë dhe vajzat kudo në botë por edhe në Shqipëri. Faleminderit!



Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Përpara se të miratojmë rendin e ditës po ju bëj me dije se Kryetari i Bashkisë ka një kërkesë për shtim të një pike në rendin e ditës:

Për një ndryshim në Vendimin nr.6, datë 27.01.2025: "Ndryshimi i masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale nga 2568450 lekë në 3101400 lekë, për periudhën Janar -Dhjetor 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën 2481140 lekë dhe në masën 20% nga bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 620280 leke".

Kërkohet dakordësia për shtimin e pikës së kërkuar në rendin e ditës nga Kryetari i Bashkisë.

- Miratohet me vota të të gjithë këshilltarëve pjesëmarrës **shtimi në rend të ditës i pikës për një ndryshim në Vendimin nr.6, datë 27.01.2025 : "Ndryshimi i masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale nga 2568450 lekë në 3101400 lekë, për periudhën Janar -Dhjetor 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën 2481140 lekë dhe në masën 20% nga bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 620280 leke"**

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 28.04.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.03.2025.
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Mars 2025.
4. Miratimi me Vendim i Raportit të Veprimtarisë dhe Vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024.
5. Projektvendim për përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njërive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionimit të qirasë në bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2025. (Rishqyrtim)
6. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
7. Pikë e shtuar: Për një ndryshim në në Vendimin nr.6, datë 27.01.2025 : "Ndryshimi i masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale nga 2568450 lekë në 3101400 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën 2481140 lekë dhe në masën 20% nga bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 620280 leke"
8. Të ndryshme.



Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 1 e rendit të ditës: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 28.04.2025.

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës me pikën e shtuar përmes votimit:

- Miratohet rendi i ditës me votat e plota të këshilltarëve pjesëmarrës:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 2 e rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.03.2025. Nuk ka diskutime.

Atëherë ju ftoj të miratojmë Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.03.2025.

- Miratojmë Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.03.2025 me:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 3 e rendit të ditës: Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Mars 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

Sidorela Katroshi, Drejtoreshë e Zyrës së Emigracionit dhe Çeshtjeve Sociale, shpjegon se për muajin Mars 2025 kemi propozuar për ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, 31 familje, me fond 122,430 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 2,040,515 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në shumën 120,808 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 15 familje me fond 50,758 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë .
3. Njësia Blerim , 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Fierzë , 4 familje me fond 21,602 lekë .
5. Njësia Iballë , 5 familje me fond 20,136 lekë .



Sidorela Katroshi, Drejtoreshë e Zyrës së Çështjeve Sociale në Bashki, shpjegon më tej se shtohet në bllok-ndihmën e 6% familja: Valter Praela (Njësia Administrative Fierzë) si familje në vështirësi .Largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja: Dallendyshe Mhill Ndreca (Njësia Administrative Fierzë) për riaplikim në Ndhimë Ekonomike.

Franc Doda, anëtar i Komisionit të Mirëqenies Sociale:

Ne si komision kemi rënë dakord me propozimin e zyrës përkatëse dhe me shpjegimet e dhëna. Kemi pasë present në mbledhjen e komisionit edhe Specialistët e Ndhimës Ekonomike të Njësive Administrative: Agim Cenaj, Specialist i Ndhimës Ekonomike ne Njësine Administrative Iballe dhe Diana Toma Specialiste e Ndhimës Ekonomike në Njësine Administrative Qafë-Mali, të cilët shpjeguan me detaje lidhur me përfituesit e 6 % të Ndhimës Ekonomike.

Sot këtu kemi present edhe dy speialistët e Ndhimës ekonomike të dy Njësive të tjera, përkatësisht për Blerimin, Ziada Xhauri dhe për Fierzën Gentian Ndoci, të cilët kanë shpjeguar paraprakisht çdo dilemë që kishim.

Ne jemi gjithnjë për përfitim të kësaj vlere të gjithë ato persona që plotësojnë kriteret.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Mars 2025 përmes votimit:

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Mars 2025 me:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 4 e rendit të ditës: Miratimi me Vendim i Raportit të Veprimtarisë dhe Vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Raportit të Veprimtarisë dhe Vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është pasqyruar dhe relatuar nga Sekretarja e Këshillit Bashkiak, Naze Selimaj në mbledhjen e Këshillit të datës 28.02.2025 dhe kemi rënë dakord. Tani na duhet t'a kthejmë në vendim.

Nuk ka pyetje as diskutime.

Ftoj këshilltarët të miratojmë me votë Raportin e Veprimtarisë dhe Vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024.



- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Raporti i Veprimtarisë dhe Vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 5 e rendit të ditës: Projektvendim për përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionimit të qirasë në bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2025. (Rishqyrtim)

Ky projektvendim është shqyrtuar në mbledhjen e datës 27.01.2025, diskutuar dhe rënë dakord nga ana jonë me votë. Prefektura e ka kthyer për rishqyrtim sepse është dashur të përcaktohet çmimi i qirasë jo vetëm për zonat urbane por edhe për ato rurale.

Kjo kërkesë për shqyrtim është pasqyruar në projekt nga ana e zyrës përkatëse konkretisht:

Në zbatim të ligjit Nr.22/2018, “ Për strehimin social”, VKM Nr.459.dt 03.07.2019, “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qerasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM Nr.362 dt 29.05.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qerasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” pika 4a e këtij vendimi: Njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vlerën konkrete të subvencionimit të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social në tregun e lirë, bazuar në vlerën mesatare të qirave e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane e rurale.

Prandaj lind nevoja edhe njëherë të miratojmë projektvendimin për përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve të banimit në treg, për efekt të zbatimit të programit subvencionim i qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, masë e cila llogaritet në varësi të çmimit mesatar të qirasë në treg për zonat urbane dhe rurale. Nga tw gjitha studimet e bëra rezulton se:

Çmimi mesatar i qirave të banesave për efekt subvencionimi të qirasë sipas strukturës për zonat urbane dhe rurale janë si më poshtë:

	Urbane	Rurale
a) Për apartament të tipit "Garsonierë"	7000 lekë/muaj	5000 lekë/muaj
b) Për apartament të tipit 1+1	12000 lekë/muaj	8000 lekë/muaj
c) Për apartament të tipit 2+1	15000 lekë/muaj	10000 lekë/muaj
d) Për apartament të tipit 3+1	23000 lekë/muaj	13000 lekë/muaj

Ky nivel çmimesh propozuar në këtë projektvendim është arritur në përfundimin referuar ofertave të marra në treg për çmimin e qirave të apartamenteve në qytetin Fushë-Arrëz dhe periferi për vitin kalendarik 2024 si dhe kontratave noteriale qiraje të shoqëruara me kërkesën për strehimin social nga programi i subvencionimit të qirasë.

Nuk ka pyetje as diskutime.

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionimit të qirasë në bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2025:

- Miratohet me vota të të gjithë pjesëmarrësve projektvendimi: Përcaktimi i çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionimit të qirasë në bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2025 për zonat urbane dhe rurale:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstënim

Pika numër 6 e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

Nuk ka kërkesa apo ankesa për t'u trajtuar në këtë mbledhje.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 7 e rendit të ditës: Për një ndryshim në në Vendimin nr.6, datë 27.01.2025 : "Ndryshimi i masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale nga 2568450 lekë në 3101400 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën 2481140 lekë dhe në masën 20% nga bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 620280 lekë".

Mikel Qafa, Zëvendëskryetar i bashkisë:

Është projekti nr.13 që keni në dosjet tuaja. Bazuar në ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social" dhe bazuar mbi të gjithë bazën ligjore të pasqyruar në projektin e ribërë, Ministria e Financës dhe Ekonomisë na e ka diktuar një ndryshim në vendimin nr. 6 të datës 27.01.2025 për ndryshimin e masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale nga 2568450 lekë në 3101400 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën 2481140 lekë dhe në masën 20% nga bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 620280 lekë.

Duke pasë parasysh që bëhet fjalë vetëm për një ndryshim të saktësuar me formulë , unë ju ftoj t'a miratojmë këtë ndryshim.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse këshilltarët janë të qartësuar për ndryshimin në fjalë, ju ftoj të miratojmë me votë ndryshimin në vendimin nr. 6 të datës 27.01.2025 për ndryshimin e masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale nga 2568450 lekë në 3101400 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën 2481140 lekë dhe në masën 20% nga bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 620280 lekë.

- Miratohet me vota të të gjithë këshilltarëve pjesëmarrës "Ndryshimi i masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale nga 2568450 lekë në 3101400 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën 2481140 lekë dhe në masën 20% nga bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 620280 lekë":

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 8 e rendit të ditës: Të ndryshme.

Vjollca Tabakaj, anëtare e këshillit të bashkisë:

Pyetje për Kryetarin e bashkisë: Çfarë u bë me rrugën e Bugjonit?

Hil Curri Kryetari i bashkisë: Faleminderit për pyetjen Vjollca. Rruga e Bugjonit është hapur, siç e kemi thënë është tejet e vështirë në qëndrueshmërinë e saj, shpresojmë të mos kemi probleme.



Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Të nderuar këshilltarë!

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj, njëkohësisht ju uroj mbarësi në detyrat tuaja të mëtejshme!

Suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

[Handwritten signature of Naze Selimaj]

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



[Handwritten signature of Bestana Marica]
BESTANA MARICA
Valentina Heshaj
Barelkox Dorja

[Handwritten signature of Valentin Doci]
Valentin Doci

[Handwritten signature of Leshina Ceca]
Leshina Ceca
Pardun Dorja

[Handwritten signature of Lin Zof]
Lin Zof
Zof Arre
Terez e Dema

[Handwritten signature of Gjollë Tabakaj]
Gjollë Tabakaj

Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al